




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 158/15

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 30.07.2015

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin e Pronës së Paluajtshme për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

- 1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin e Pronës së Paluajtshme për vitin 2016
- 2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.
- 3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- 4.Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.
5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit






REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 159 / 15

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 30.07.2015

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit Nr.03/L40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 40.2 “dh” të Statutit të Komunës, nenit 8 të Rregullores 01Nr.37-2/11 dt.24.02.2011 mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jopublike dhe ndihmës momentale në të holla, si dhe kërkesës të dt.21.07.2015 të Xhavit Hysenit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2015**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDIHMË FINANCIARE PËR SHËRIM PËR XHAVIT HYSENIN

- 1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej dy mijë euro (2000 €) nga buxheti i komunës – programi zyra e Kryetarit nga kategoria “subvencione dhe transfere” për Xhavit Hysenin me banim në, Vushtrri Rr. “Faik Konica”.
- 2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së saj.
- 3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- 4.Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.


Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	160/15
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	30.07.2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK


1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.
5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Shpëtim Zhegrova
Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	161/15
Nr. i fq. / Br. sh	- 1 -
Data: / Datum	30.07.2015
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri



Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Planit Lokal i Veprimit për Rini, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

- 1.Jepet në diskutim publik Draft-Plani Lokal i Veprimit për Rini.
- 2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.
- 3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- 4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.
5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Planit Pesë-Vjeçar të Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë 2016-2020, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1.Jepet në diskutim publik Draft-Plani Pesë-Vjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë 2016-2020.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.


3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.

5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	163 / 15
Nr. i fq. / Br. sf	- 1 -
Data / Datum	30.07.2015
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 11,12 paragrafi 2 pika “d” dhe neni 40 paragrafi 2 pika “c” të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokal, neni 40 paragrafi 2 pika “dh”, dhe neni 41 paragrafi 2 pika “ç” të Statutit të Komunës, si dhe vendimit të KK-së 01nr.190/14, dt.29.09.2014, me të cilën është aprovuar buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2015, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me 30 korrik 2015, mori këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRNSFERE DHE SUBEVENCIONE

- 1.Me këtë vendim, ndahet mjetet financiare në shumën prej një mijë e pesëqind euro (1.500€) për OJQ-në “Lëvizja Koha”, për aktivitetin tradicional “PANAIR I SHKENCËS DHE KULTURËS”, këto mjete ndahen nga buxheti i komunës –fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2015.
- 2.Mjetet në shumën e cekur si në piken 1 të këtij vendimi ndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike 01Nr.37-2/11, datës 24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2014.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit



REPublika e Kosovës - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	164/15
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	30.07.2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 pika "d" të Ligjit Nr.03/L40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë pas shqyrtimit të peticionit të banorëve të fshatit Gllavatin lidhur me kundërshtimin e vendimit 01.Nr.70/14 të datës 27.03.2014 në mbledhjen e mbajtur me **30 korrik 2015** mori këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT LIDHUR ME VERIFIKIMIN E GJENDJES FAKTIKE TË VARREZAVE NË FSHATIN STROC

1.Me këtë vendim formohet komisionin komunal, për konstatimin e gjendjes faktike, të pronës komunale të destinuar për vendosjen e varrezave të fshatit Stroc, e cila është ndarë nga ana e Kuvendit të Komunës në bazë të vendimit 01.Nr.70/14 të datës 27.03.2014 në këtë përbërje:


- 1.1 Qerim Selim, anëtarë i kuvendit;
- 1.2 Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit;
- 1.3 Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit;
- 1.4 Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe
- 1.5 Rushit Bilalli, nga Drejtorja e Shërbimeve Publike.

2.Banoret e fshatit Gllavatin me anë të peticionit të parashtruar me datën 06.07.2015 e kanë kundërshtuar vendimin e Kuvendit të Komunës 01.Nr.70/14 të datës 27.03.2014, lidhur me caktimin e lokacionit të varrezave të fshatit Stroc, andaj komisioni në fjalë do të ketë për detyrë të konstatoj saktë dhe drejt gjendje faktike, dhe ti propozoi kuvendit një zgjidhje të përshtatshme.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit